




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE PRIVAT
SHOQËRIA PËRMBARIMORE
"STRATI BAILIFF'S SERVICE" Sh.p.k.



Adresa: Rr. "Jordan Misja", P 141/1, Shk 1, Ap 7, Tiranë, Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com
Cel: Gentian Strati: 0674000450; Valter Kaçupi: 0674000456; Kozeta Guri: 0674000455; Edvin Malotaj: 0674000457

Nr. 4854

Nr.3567 Prot.

Tiranë, më 03.06.2019

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit

Për dijëni : Shoqërisë "AMN Group Albania" Sh.p.k.

*Adresa: Laç, Autostrada Laç – Lezhë, Rruga Kryesore, Ndërtesë
3 katëshe*

Shoqërisë "RATECH" Sh.p.k.

Lënda : Urdhër për vendosjen e sekuestros konservative

Në Tiranë, sot më datë 03.06.2019,

Unë **Edvin Malotaj**, përmbarues gjyqësor privat pranë shoqërisë përmbarimore "Strati Bailiff's Service" Sh.p.k., me NIPT L21825003E, i pajisur me çertifikatë Nr. 106, Maj 2012 lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore, në zbatim të Urdhrit të Ekzekutimit, Vendimit Nr.343-67, datë 25.03.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin,

KONSTATOVA:

Se në datë 17.04.2019, pranë shoqërisë përmbarimore "Strati Bailiff's Service" Sh.p.k., është depozituar kërkesa e palës kreditore dhe është lidhur kontrata e shërbimit për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit, Vendimit Nr.343-67, datë 25.03.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Urdhri i ekzekutimit është lëshuar për titujt ekzekutiv, Faturën Tatimore Nr.50, si dhe Nr. Serial 59101484, datë 09.04.2018, me palë:

Kreditor : Shoqëria "RATECH" Sh.p.k.

Debitor : Shoqëria "AMB Group Albania" Sh.p.k.

Me Objekt : kthim shume

Me vendimin Nr.343-67, datë 25.03.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, është vendosur :

“Pranimin e kërkesës.

Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv Faturë Tatimore Shitje për furnizim shërbimesh nga Shoqëria RATECH Sh.p.k. me NUIS L11521021S tek blerësi AMN Group Albania Sh.p.k. me NUIS L77524301J, fatura me Nr.50, si dhe Nr. Serial 59101484, datë 09.04.2018. Detyrimi monetar sipas kësaj fature është në shumën 2.004 (dy mijë e katër) Euro deri në datën e përmbushjes së plotë të detyrimit, debitori, për çdo ditë vonesë, duhet të paguajë edhe kamatë vonesën, në përputhje me parashikimet e ligjit Nr.48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”, i ndryshuar.”

Me shkresën Nr. 2757 Prot., datë 17.04.2019 debitorit i është komunikuar afati për ekzekutimin vullnetar.

Sa më sipër bazuar në 527 e vijues të K.Pr.Civile, Ligjit Nr.10031 datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Privat” dhe Udhëzimit Nr. 385/7, datë 28.06.2017 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor privat”

URDHËROJ:

- 1- Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të vendosë masën e sekuestros konservative mbi aktivet e rregjistruara pranë jush që zotëron pala debitor:
 - Shoqërisë “AMN Group Albania” Sh.p.k. me NIPT L77524301J, me përfaqësues ligjor Z. Altin Selmanaj, për ekzekutimin e vendimit Nr.343-67, datë 25.03.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.
- 2- Këto aktive të qëndrojnë të bllokuara deri në një urdhër të dytë.
- 3- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- 4- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile.
- 5- Ky urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 ditëve.

Përmbarues Gjyqësor Privat

Edvin Malotaj

